

## AKTI THEMELIMI

### I

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “TRINOMIAL” SHPK

Sot me datë 28/05/2024, Z. Gerion TRESKA, shtetas shqiptar, i datëlindjes 07.07.1988, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me Numër Personal I80707084W, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

### NENI 1

#### Themelimi

Emri i shoqërisë është “TRINOMIAL” SH.P.K.

Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “TRINOMIAL” SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi si dhe në Statutin vijues.

### NENI 2

#### Qëllimi i krijimit të shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në Statutin e saj. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

### NENI 3

#### Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “TRINOMIAL” SHPK. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

### NENI 4

#### Objekti i veprimtarisë

Përshkimi i Aktivitetit

Konsulencë biznesi, konsulencë startup-esh, konsulencë financiare, konsulencë e këshillim në edukim, zhvillim i programeve software, konsulencë për shërbime transformimi digjital, marketing digjital, trajnime dhe mentorime të gjitha fushave si më sipër por jo vetëm.

## NENI 5

### **Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet në: Rr. Tish Daija, Kompleksi KIKA2, Hyrja 10, Kati 7, Tiranë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## NENI 6

### **Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind lekë), i ndarë në 1 kuota me vlerë nominale të një kuote prej 100 (njëqind) lekë.

Ortakët themelues të shoqërisë Tregtare “TRINOMIAL” SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Z. Gerion TRESKA zotërues i 100 % (njëqind përqind) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë;

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi me i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### **Administratori**

Shoqëria administratohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjecar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Gerion TRESKA. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 9**

### **Të tjera**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statuti.

## **NENI 10**

### **Ruajtja e sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## **NENI 11**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata Kompetente.

## **NENI 12**


### **Nënshkrimi**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa verejtje.

Ky akt Themelimi hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

## **ORTAKET THEMELUES**

**Znj. Gerion TRESKA**

 GERION TRESKA.